

## Sesionet e Provimeve

1. Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Datat e tyre propozohen nga sekretaritetë mësimore me zv. Dekanin për anën mësimore, në bashkëpunim me departamentet, miratohen nga Dekani dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sesionit.
2. Provimet zhvillohen në tre sesione:
  - sesioni i provimeve të dimrit, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të parë;
  - sesioni i provimeve të verës, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të dytë;
  - sesioni i provimeve të vjeshtës, i cili zhvillohet në Shtator.
3. Nëse studenti nuk ka shlyer detyrimet e lëndës në kohën normale të zhvillimit të saj, sipas nenit 32 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, ai duhet t'i shlyejë ato para fillimit të sesionit të provimeve, në periudhën e shpallur në strukturën mësimore. **Nuk lejohet shlyerja e detyrimeve të lëndës përgjatë sesionit të provimeve.**
4. Studenti, nuk lejohet të hyjë më shumë se një herë në provimin e një lënde, brenda një sesioni.
5. Studenti mund të marrë më shumë se numri maksimal i krediteve të përcaktuara në planin dhe programin mësimor për çdo vit akademik, nëse ka plotësuar të gjitha parakushtet e hyrjes në provim.
6. Studenti është i detyruar të paraqitet në provim me dokument identifikimi me fotografi (libreza e studentit, karta e identitetit ose karta e studentit), në të kundërt ai nuk lejohet të futet në provim dhe pasojat rëndojnë mbi studentin. Në përfundim të provimit, komisioni shënon në librezën e studentit notën e vlerësimit me numër e me fjalë, duke vënë firmën secili anëtar i komisionit.
7. Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të dyshimta elektronike. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës së UPT.

8. Provimet me shkrim bëhen të sekretuar dhe zgjasin 2-4 orë. Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse. Sistemi i pikëve dhe konvertimi përkatës me notë, që përdoret në provimin me shkrim, i bëhet të njohur studentit para fillimit të provimit.
9. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se pesë ditë pune nga data e dhënies së provimit. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi komisionin e provimit.
10. Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës sipas nenit 36 *Fletët e provimit*, të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur.
11. Studenti merr vlerësimin kalues në një lëndë kur:
  - ka plotësuar të gjitha parakushtet e përcaktuara sipas programit mësimor;
  - vlerësohet me notë kaluese sipas formës së kontrollit që parashikon programi i lëndës.Në rast të kundërt studentit, nuk konsiderohet kalues.
12. Provimet e studentëve ruhen në departament për një periudhë të paktën gjashtë mujore pas përfundimit të sesionit të provimeve.